

Në bazë të nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit për zejtari (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 215/2015).Ministri i Ekonomisë miratoi

**R R E G U L L O R E**  
**PËR KUSHTET MINIMALE TEKNIKE QË DUHET TË PËRMBUSHIN HAPËSIRAT NË**  
**TË CILAT KRYHET VEPRIMTARIA ZEJTARE**

Neni 1

Me këtë rregullore përshkruhen kushtet minimale teknike që duhet të përmbushin hapësirat në të cilat kryhet veprimtaria zejtare.

Neni 2

Hapësirat në të cilat kryhet veprimtaria zejtare duhet të kenë së paku 2.5 m lartësi dhe sipërfaqe 5 m<sup>2</sup>. Në rastin e hapësirave me kulm të pjerrët, lartësia minimale nuk duhet të jetë më e vogël se 2,2 m.

Neni 3

Sipërfaqja e hapësirës së destinuar për lëvizjen e punonjësve duhet të dimensionohet për të mundësuar lëvizjen e lirë dhe të sigurt të punonjësve.

Neni 4

Në hapësirat, në varësi të llojit të veprimtarisë dhe lëndës së parë që përpunohet, duhet të sigurohet ventilim natyral ose artificial.

Nëse në hapësirat, gjatë kryerjes së veprimtarisë, shfaqen gazra, avuj, mjegull ose pluhur në sasi të padurueshme ose përqendrim që nuk mund të parandalohet, duhet të vendosen pajisje thithëse dhe pastrimi, të cilat do të vendosen direkt mbi pajisjen që të njejtat i krijon.

Neni 5

Në hapësirat në të cilat kryhet veprimtaria zhurma duhet të jetë brenda niveleve të lejuara në përputhje me rregulloret për mbrojtjen nga zhurma.

Neni 6

Në hapësirat përderisa zgjat orari i punës në përputhje me kushtet e jashtme dhe nevojat e punonjësve, duhet të sigurohet temperaturë e përshtatshme.

Neni 7

Hapësirat duhet të jenë të ndriçuara mirë për të siguruar shikueshmëri të mirë.

Ndërprerësit e ndriçuesit duhet të instalohen pranë dyerve.

Neni 8

Dyshemeja në hapësirat nuk duhet të jetë e rrëshqitshme dhe e pa rrafshhtë dhe duhet të lejojë mirëmbajtjen e lehtë të pastërtisë. Sipërfaqja e mureve duhet të jetë e tillë që të lejojë pastrim të lehtë. Në rastin e mureve transparente ose të mureve të bëra me elementë xhami, ato duhet të jenë

prej një materiali i cili kur thyhet, nuk mund të shkaktojë lëndime fizike. Çatia është bërë nga materiale standarde në përputhje me rregulloret në fushën e ndërtimit.

#### Neni 9

Dritaret dhe ndriçimi i çatisë duhet të pajisen për të parandaluar rrezet e diellit direkte.

Dritaret që hapen në pjesën e sipërme duhet të kenë një mekanizëm të përshtatshëm hapjeje dhe mbylljeje.

#### Neni 10

Pozicioni, numri, dizajni dhe dimensionet e dyerve duhet të varen nga lloji I hapësirave dhe përdorimi i tyre.

Dyert duhet të jenë dukshme ose të kenë një hapje përmes së cilës mund të sigurohet dukshmëria.

#### Neni 11

Hapësirat duhet të jenë të pajisura me larëse të duarve dhe tualete.

Nëse veprimtaria zejtare kryhet ekskluzivisht nga zejtari, hapësirat nuk duhet të kenë tualet.

Në varësi të natyrës së veprimtarisë zejtare si dhe numrit të punonjësve, hapësirat duhet të kenë edhe banjë.

Nëse ka punonjës të të dy gjinive (meshkuj dhe gra), tualetet dhe banjat duhet të jenë të ndara.

#### Neni 12

Shkallët lëvizëse dhe korsitë e pafundme që shfrytëzohen për transportin e punonjësve duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të garantojnë sigurinë e transportit .

Shkallët lëvizëse dhe korsitë e pafundme duhet të pajisen në rast rreziku për shfrytëzuesin, me pajisje mbyllëse lehtësisht të dallueshme, e cila duhet të vendoset në një vend lehtësisht të aksesueshëm.

#### Neni 13

Rampa e ngarkim-shkarkimit duhet të jetë së paku 0.80 m e gjerë dhe të ketë të paktën një dalje.

Për rampat më të gjata se 20 m, rekomandohet të ketë dalje në çdo skaj. Daljet duhet të jenë në formën e shkallëve ose shpateve.

#### Neni 14

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon së vlefshmi Rregullorja për plotësimin e kushteve minimale teknike për kryerjen e veprimtarisë zejtare (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 87/04).

#### Neni 15

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_viti 2022

Shkup

Ministri i Ekonomisë,  
**Kreshnik Bekteshi**